



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 1452/1 prot.

Tiranë, më 27.05.2025

VENDIM

Nr. 13, datë 27.05.2025

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Znj. (në vijim “ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1452 Prot., datë 23.05.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Shoqërisë “Curri” sh.p.k.

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës datë 20.03.2025, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion *akt kontrollet që janë mbajtur mbi zbatueshmërinë e projektit për investimin publik me objekt “Zdrallë – Rijetëzimi urban i Pazarit të Shkodrës, Lot A – Rr. Hamz Kazazi”*.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi Shoqëria “Curri” sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën për informacion, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi...*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës*

administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”, ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative, “Curri” sh.p.k. Nga verifikimi rezulton se, “Curri” sh.p.k., është shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit J67902718S. Referuar ekstraktit të Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit, rezulton se “Curri” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me 100% aksione private.

Ndërkohë, objekti i LDI, është garantimi i njohjes së publikut me *informacion/dokumentacion publik*, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e LDI *“Autoritet publik”*: a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative”*, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Shoqëria “Curri” sh.p.k., nuk është autoritet publik në kuptim të LDI. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitimit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 1452 Prot., datë 23.05.2025, të znj. _____, kundër Shoqërisë “Curri” sh.p.k., me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 27.05.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi